



# MOSVEPRIMI I KUVENDIT SHKEL TË DREJTAT E 90,696 ZYRTARËVE PUBLIK DHE RREZIKON BUXHETIN SHTETËROR



VIII. TË URDHËROJË, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 116 [Efekti Juridik i Vendimeve] të Kushtetutës, Kuvendin e Republikës së Kosovës, që brenda gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 2 të nenit 196 për Pagat në Sektorin Publik, në pajtim me Kushtetutën dhe këtë Aktgjykim;



XIII. Ky Aktgjykim, bazuar në paragrafin 5 të nenit 20 (Vendimet) të Ligjit, hyn në fuqi më 1 shkurt 2024.



Autorë: Gzim Shala dhe Naim Jakaj

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund.

Implementuar nga:



Mbështetur nga:



RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

Adresa: Rr. Ilaz Agushi, nr. 146  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Mars, 2025  
Prishtinë, Republika e Kosovës



# Përmbajtja

---

<b>07</b>	<b>Përmbledhje ekzekutive</b>	<b>12</b>	<b>Pasojat socio-ekonomike</b>
<b>08</b>	<b>Pagesa për përvojë të punës</b>	<b>13</b>	<b>Mbrojtja gjyqësore e të drejtave</b>
<b>08</b>	<b>Çfarë vendosi Gjykata Kushtetuese?</b>	<b>15</b>	<b>Annex 1: Padia kundër Kuvendit</b>
<b>09</b>	<b>Dështimi i Kuvendit</b>		
<b>10</b>	<b>Realizimi kolektiv vs. Individual i të drejtave</b>	<b>16</b>	<b>Udhëzime për plotësimin e padisë</b>
<b>11</b>	<b>Dëmet institucionale dhe buxhetore në rast mosveprimi</b>	<b>17</b>	<b>Forma e padisë</b>



## Përmbledhje ekzekutive

Më 5 shkurt 2023, hyri në fuqi Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili reduktoi përqindjen e shtesës mbi përvojën e punës për 15 vitet e para nga 0.5% në 0.25%. Ky ndryshim preku negativisht mbi 90,000 zyrtarë publik.

Në vendimin KO79/23, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ulja e pagesës për përvojën e punës është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata nuk e shfuqizoi dispozitën, por e detyroi Kuvendin që brenda gjashtë muajve (deri më 1 gusht 2024) ta rikthejë pagesën e përvojës së punës në të paktën 0.5%, e cila lartësi duhej të shtrihej nga data 1 shkurt 2024.

Përballë obligimit që pati, që deri më 1 gusht 2024 ta plotësojë dhe ndryshojë Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik në raport me përqindjen e pagesës së përvojës së punës, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk përmbushi këtë obligim kushtetues. Për nga fuqia e tyre, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekuivalente me normën kushtetuese. Për këtë arsye, mosveprimi i Kuvendit në raport me obligimin e caktuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e Kuvendit.

Ky mosveprim i Kuvendit përballë obligimit Kushtetues që ka, i cili mosveprim cenon të drejtat e gjithë zyrtarëve publik, është një shembull skajshmërisht negativ. Përpos shkelje kushtetuese dhe cenim i të drejtave të zyrtarëve publik, në kontekstin e sfidave socio-ekonomike aktuale, zbritja e përvojës së punës nga 0.5 në 0.25% sjellë pasoja në jetën e familjeve të 90,696 zyrtarëve publik.

Në këtë situatë, tashmë zyrtarët publik kanë pësuar dëm. Nëse Kuvendi nuk vepron, zyrtarët publik e kanë të drejtën që të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, duke kërkuar përmes Gjykatës kompensimin e dëmit që i'u është shkaktuar nga mosveprimi i Kuvendit. Nëse Kuvendi nuk vepron dhe zyrtarët publik detyrohen ti drejtohen gjykatës, potenciali në këtë rast është se gjykatat do të vërshohen me rreth 90.000 lëndë të reja, të cilat do duhet t'i trajtojnë një për një.

Përpos vërshimit të gjyqësorit me lëndë, që prek efikasitetin e gjyqësorit në përgjithësi, nëse zyrtarët publik obligohen që të drejtat e tyre t'i realizojnë përmes rrugëve gjyqësore, atëherë nga buxheti i Republikës së Kosovës duhet të paguhen edhe shpenzimet procedurale dhe kamata ligjore. Në bazë të një kalkulimi të përgjithshëm, nga buxheti i Kosovës do të shpenzohen 35,770,502 euro për shpenzime procedurale, pa përfshirë kamatën ligjore dhe shpenzimet e mundshme përmbartimore.

Nëse Kuvendi nuk vepron sipas obligimit kushtetues, zyrtarët publik do të duhet të ndjekin rrugën gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre. Duke rekomanduar fuqishëm që kjo çështje të zgjidhet në mënyrë kolektive, përmes veprimit të Kuvendit sipas obligimit kushtetues, nëse kjo nuk ndodhë, IKD ka përgatitur një formë të padisë, e cila është lehtësisht e përdorshme për zyrtarët që vendosin të padisin Kuvendin për shkaktim të dëmit përmes mosveprimit. Kjo formë e padisë është pjesë e kësaj analize.

## 2. PAGESA PËR PËRVOJË TË PUNËS

Deri me 5 shkurt 2023, kur kishte hyrë në fuqi Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, pagat e të punësuarve në sektorin publik kanë qenë të rregulluara me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Ligji Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, krahas të tjerave, rregullonte edhe shtesën mbi pagën e përvojës së punës. Sipas këtij Ligji [neni 18.1], “[p]ër çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta shtesë në pagën bazë prej 0,5%”.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, më 5 shkurt 2023, përqindja e shtesës mbi përvojën e punës pësoi ndryshime. Sipas këtij Ligji [neni 6.6]:

“Paga bazë rritet në bazë të përvojës së punës, në masën:

- 6.1. zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe
- 6.2. zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë”.

Kështu, Ligji i ri për Pagat në Sektorin Publik e ruajti përqindjen e pagesës së përvojës së punës vetëm për periudhën mbi 15 vite përvojë punë. Ndërsa, për periudhën kohore deri në 15 vite përvojë pune, Ligji i ri e uli përqindjen e pagesës nga 0.5% në 0.25%.

## 3. Çfarë vendosi Gjykata Kushtetuese?

Me kërkesë të Institutit të Kosovës për Drejtësi<sup>[1]</sup> dhe 104 ankesave të tjera nga subjektet e sektorit publik, ankesave individuale dhe ankesave nga sindikatat, Avokati i Popullit, kërkoi nga Gjykata Kushtetuese vlerësimin kushtetues të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.<sup>[2]</sup> Objekt i trajtimit të Gjykatës Kushtetuese në këtë rast, ndër të tjera, ishte edhe çështja e zbritjes së përqindjes së pagesës për 15 vitet e para të përvojës së punës nga 0.5% në 0.25%.

Në aktgjykimin e nxjerrë përkitazi me kushtetutshmërinë e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, përkatësisht aktgjykimin në rastin KO79/23, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se reduktimi i pagesës për zyrtarët publik gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të karrierës së tyre, nuk është në përputhje me synimin e ligjit për të krijuar një sistem të unifikuar të pagave në sektorin publik.

[1] IKD ka deponuar kërkesën tek Avokati i Popullit që ta procedojë Ligjin për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese; Instituti i Kosovës për Drejtësi; 6 janar 2023; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-ka-deponuar-kerkesen-tek-avokati-i-popullit-qe-ta-procedoje-ligjin-per-pagat-ne-sektorin-publik-ne-gjykatën-kushtetuese/>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

[2] Kërkesë Ex-Officio 76/2023 për vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik; Institucioni i Avokatit të Popullit; 7 prill 2023; (Shih linkun: <https://oik-rks.org/2023/04/07/avokati-i-popullit-i-drejtohet-gjykatës-kushtetuese-te-republikes-se-kosoves-me-kerkese-ex-officio-762023-per-vlerësimin-e-perputhshmerise-me-kushtetuten-te-ligjit-nr-08l-196-per-pagat-ne-sektorin/>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).



Në këtë rast, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se ky veprim nuk është mbështetur nga një "qëllim legjitim" dhe, si rrjedhojë, nuk ka nevojë të shqyrtohet proporcionaliteti, pasi mungesa e një qëllimi legjitim nënkupton një shkelje të të drejtës në pronësi. Sipas këtij vendimi, Gjykata ka konkluduar se ky reduktim i pagesës së përvojës së punës nuk është në harmoni me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me neni 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për mbrojtjen e pronës.[3]

Kështu, Gjykata Kushtetuese konstatoi se neni 6.6 i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, që ulë pagesën e përvojës së punës për 15 vitet e para të karrierës nga 0.5% në 0.25%, nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Siç mund të shihet edhe në arsyetimin e cituar, Gjykatat Kushtetuese nuk e shfuqizoi dispozitën në fjalë por e obligoi Kuvendin që brenda gjashtë muajve (deri më 1 gusht 2024) ta ndryshojë këtë dispozitë, duke mbrojtur nivelin e pagesës lidhur me përvojën e punës. Gjykata Kushtetuese e bëri këtë për shkak se sikur kjo dispozitë të shfuqizohej, atëherë çështja e pagesës së përvojës së punës do të kalonte në një zbrastësi juridike, për faktin se Ligji Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik shfuqizoi Ligjin paraprak që njihte këtë të drejtë.[4]

Në këtë situatë, përmes aktgjykimit në fjalë, Gjykata Kushtetuese e obligoi Kuvendin e Republikës së Kosovës që në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në pajtim me Kushtetutën dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KO79/23. Sipas Gjykatës Kushtetuese, efekti i ndryshimit të Ligjit duhej të shtrihej nga data e nxjerrjes së aktgjykimit dhe jo nga data e miratimit.[5]

Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese e obligoj Kuvendin e Republikës së Kosovës që brenda afatit prej gjashtë (6) muajve të kthejë dispozitën lidhur me pagesën e përvojës së punës në të paktën 0.5%, e cila pagesë do të realizohej nga data e hyrjes në fuqi të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (1 shkurt 2024).

## 4. Dështimi i Kuvendit

Përballë obligimit që pati, që deri më 1 gusht 2024 ta plotësojë dhe ndryshojë Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik në raport me përqindjen e pagesës së përvojës së punës, Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk përmbushi këtë obligim kushtetues. Kërkesa për ta zbatuar një aktgjykim të tillë pati edhe nga ana e shoqërisë civile[6] dhe nga ana e sindikatave që përfaqësojnë zyrtarët publik.[7]

---

[3] Aktgjykim në rastin nr. KO79/23, par. 362-372, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik; Gjykata Kushtetuese e Kosovës; 23 janar 2024; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85575>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

[4] Po aty, par. 380-388.

[5] Po aty, par.380-382.

[6] IKD: Qeveria dhe Kuvendi shpërfillin Gjykatën Kushtetuese, cenohen të drejtat e mijëra shërbyesve civilë në Kosovë; Instituti i Kosovës për Drejtësi; 13 gusht 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-qeveria-dhe-kuvendi-shperfillin-gjykatën-kushtetuese-cenohen-te-drejtat-e-mijera-sherbyesve-civile-ne-kosove/>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

[7] IKD: Qeveria dhe Kuvendi të nisin me urgjencë zbatimin e Aktgjykimit për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik; Instituti i Kosovës për Drejtësi; 15 nëntor 2024; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ikd-qeveria-dhe-kuvendi-te-nisin-me-urgjence-zbatimin-e-aktgjykimit-per-ligjin-per-pagat-ne-sektorin-publik/>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

Sipas nenit 116 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës “Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës”. Për nga fuqia e tyre, aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese janë ekuivalente me normën kushtetuese. Për këtë arsye, mosveprimi i Kuvendit në raport me obligimin e caktuar nga ana e Gjykatës Kushtetuese paraqet shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës nga ana e Kuvendit.

Përpos shkeljes kushtetuese, përmes mosveprimit, Kuvendi i Republikës së Kosovës u ka shkaktuar dëm 90,696 zyrtarëve publik[8]. Kjo pasi që nga data 1 shkurt 2024 dhe deri më sot, për 15 vitet e para të përvojës së punës, zyrtarët publik janë duke u paguar në lartësi prej 0.25% të pagës, përderisa do duhej që pagesa të ishte në nivelin prej, të paktën, 0.5% të pagës.

Ky mosveprim i Kuvendit përballë obligimit Kushtetues që ka, i cili mosveprim cenon të drejtat e gjithë zyrtarëve publik, është një shembull skajshmërisht negativ. Të zgjedhurit e popullit do duhej që në mënyrë proaktive të mbronin të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe asesi të bëheshin shkelës të të drejtave të cilat u mbrojtën nga Gjykata Kushtetuese.

## 5. Realizimi kolektiv vs. Individual i të drejtave

Duke pasur parasysh ruajtjen e së drejtës së zyrtarëve publik në pagesën e përvojës së punës në lartësi prej 0.5% dhe mosveprimin e Kuvendit përballë obligimit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese, është e qartë se çdo ditë zyrtarët publik janë duke u dëmtuar nga ky mosveprim. Normalisht, në këtë situatë, zyrtarët publik konsiderohen persona të cilëve u është shkaktuar dëm përmes mosveprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë situatë, është shumë e rëndësishme që Kuvendi i Republikës së Kosovës, në momentin e konstituimit të Legjislaturës së IX-të, ta trajtojë me urgjencë këtë çështje, duke plotësuar dhe ndryshuar Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ashtu që të garantojë nivelin e pagesës së përvojës së punës në lartësi prej 0.5%. Shtrirja e kësaj pagese, siç kërkohet nga Gjykata Kushtetuese, duhet të jetë nga data 1 shkurt 2024.

Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nga ana e Kuvendit do të paraqiste realizim kolektiv të të drejtave të zyrtarëve publik. Në këtë mënyrë, përmes një veprimi të vetëm, plotësimit dhe ndryshimit të ligjit në fjalë, të gjithë zyrtarët do të kompensoheshin për pjesën e papaguar të përvojës së punës, nga data 1 shkurt 2024, dhe tutje pagesa e përvojës së punës do të bëhej në nivelin prej 0.5%.

Megjithatë, nëse kjo nuk ndodh, zyrtarët publik tashmë e kanë të drejtën që të kërkojnë mbrojtje gjyqësore, duke kërkuar përmes Gjykatës kompensimin e dëmit që i'u është shkaktuar nga mosveprimi i Kuvendit. Por, kjo mënyrë e realizimit të të drejtave nuk është kolektive si në rastin e parë por është individuale. Kjo nënkupton ndjekjen e procedurës gjyqësore, një për një, nga secili zyrtarë publik. Nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk vepron në përputhje me obligimin që ka sipas aktgjykimet të Gjykatës Kushtetuese, atëherë realizimi individual i të drejtave mbetet mundësia e vetme e zyrtarëve publik.

---

[8] Ligji Nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2025, fq. 29; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 12 dhjetor 2024; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=99639>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

Në raport me realizimin kolektiv të të drejtave, procedura për realizimin individual të të drejtave ka pasoja të gjera institucionale dhe buxhetore, për të cilat do të flasim në kapitullin pasues.

## 6. Dëmet institucionale dhe buxhetore në rast mosveprimi

Siç u tha, nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk vepron sipas obligimit kushtetues, zyrtarët publik obligohen që në mënyrë individuale të kërkojnë nga Gjykata shpërblimin e dëmit që u është shkaktuar dhe u shkaktohet në vazhdimësi si pasojë e mosveprimit të Kuvendit. Detyrimi i zyrtarëve publik që të realizojnë të drejtat e tyre në këtë mënyrë do të ketë pasoja të gjera institucionale dhe buxhetore. Aktualisht, në Kosovë janë gjithsej 90,696 zyrtarë publik[9]. Të gjithë këta janë prekur negativisht nga mosveprimi i Kuvendit sipas obligimit kushtetues për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Fillimisht, duhet theksuar se për shkak të mos përmbushjes së obligimeve nga ana e institucioneve të administratës publike, gjyqësori tashmë është mbingarkuar me lëndë. Mos zbatimi i obligimeve të cilat derivojnë nga kontratat kolektive dhe mos njohja e pensioneve të dyfishta ka detyruar zyrtarët publik që ti drejtohen gjyqësorit për realizimin e të drejtave të tyre. Për këtë arsye, numri i lëndëve në gjyqësor është rritur tejmasë[10]. Përderisa në vitin 2018[11] numri i lëndëve të pazgjidhura ishte 44,213 lëndë, në fund të vitit 2024[12] ky numër ka arritur në 121,324 lëndë. Kjo qasje e vërshon gjyqësorin me lëndë, duke cenuar kapacitetet e sistemit gjyqësor për t'iu dhënë drejtësi qytetarëve brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Nëse një situatë e tillë përsëritet edhe në raport me mosveprimin e Kuvendit në lidhje me pagesën e përvojës së punës, atëherë gjyqësori rrezikon të vërshohet përsëri me lëndë. Potenciali në këtë rast është se gjykatat do të vërshohen me rreth 90.000 lëndë të reja, të cilat do duhet ti trajtojnë një për një. Kjo situatë do ta dëmtoj në thelb resurset e sistemit gjyqësor të Kosovës derisa kohëzgjatja e trajtimit të të gjitha rasteve do të rritet.

Në anën tjetër, përpos dëmtimit të gjyqësorit, një qasje e tillë do ta dëmtonte jashtëzakonisht shumë buxhetin e Republikës së Kosovës. Nëse Kuvendi vepron sipas obligimit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese, nga buxheti i Republikës së Kosovës duhet të paguhet vetëm pjesa e papaguar në lidhje me përvojën e punës, retroaktivisht nga data 1 shkurt 2024.

Por, nëse kjo nuk ndodhë dhe zyrtarët publik obligohen të ndjekin të drejtat e tyre rast për rast, atëherë nga buxheti i Republikës së Kosovës duhet të paguhet edhe shpenzimet procedurale dhe kamata ligjore. Për ta gjeneruar një shumë të përafërt të dëmeve që do ti krijoheshin buxhetit të Republikës së Kosovës nëse ndjeket kjo mënyrë e realizimit të të drejtave të zyrtarëve publik, po bëjnë një kalkulim të përgjithshëm të shpenzimeve procedurale që krijohen në secilin rast.

[9] Ligji Nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për Vitin 2025, fq. 29; Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës; 12 dhjetor 2024; (Shih linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=99639>), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

[10] Gzim Shala; *Gjykimi-brenda-afatit-te-arsyeshem*, f.11-12; Instituti i Kosovës për Drejtësi; (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2024/07/Gjykimi-brenda-afatit-te-arsyeshem-1.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 10 tetor 2025).

[11] *Raporti vjetor statistikor per vitin 2018 mbi punen gjykatave*; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; 12 dhjetor 2024; (Shih linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/Raporti\\_vjetor\\_statistikor\\_per\\_vitin\\_2018\\_mbi\\_punen\\_gjykatave\\_Shq.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/Raporti_vjetor_statistikor_per_vitin_2018_mbi_punen_gjykatave_Shq.pdf)), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

[12] *Raporti statistikor i gjykatave*, vjetori 2024; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; 12 dhjetor 2024; (Shih linkun: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/59474\\_KGJK-RAPORTI\\_PERGJITHSHEM\\_VJETOR\\_2024.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/reports/59474_KGJK-RAPORTI_PERGJITHSHEM_VJETOR_2024.pdf)), (Qasur për herë të fundit me 20 shkurt 2025).

Për trajtimin e një rasti duhet të ngritet padia, të mbahet seanca përgatitore dhe shqyrtimi kryesor. Këto veprime procedurale po i llogarisim në minimalen e tyre, duke pasur parasysh se mund të ndodhë që të ketë veprime procedurale shtesë, të cilat rezultojnë edhe në ngritje të shpenzimeve procedurale. Sipas Rregullores për Tarifat e Avokatëve[13], draftimi i padisë në këtë rast ka koston prej 104 euro, derisa përfaqësimi i avokatit në një seancë kap vlerën prej 135,20 euro. Ndërsa, taksa më e ulët gjyqësore është 20 euro[14]. Nëse e marrim si total, përpilimi i padisë, taksa gjyqësore, përfaqësimi në seancën përgatitore dhe përfaqësimi në shqyrtimin kryesor kapin vlerën prej 394.4 euro. Kjo vlerë është minimale, duke pasur parasysh mundësinë e veprimeve procedurale shtesë, të cilat rezultojnë edhe në ngritjen e shpenzimeve procedurale.

Nëse kjo shumë shumëzohet me numrin e zyrtarëve publik, i bie se potencialisht, buxheti i Republikës së Kosovës do të dëmtohet minimalisht 35,770,502 euro. E gjithë kjo duke mos kalkuluar kamatën ligjore dhe mundësinë që këto raste të gjenerojnë shpenzime të veçanta edhe në procedurë përmbarimore.

Kështu, nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk vepron sipas obligimit të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese dhe obligon zyrtarët publik ti drejtohen Gjykatës, dëmi që i shkaktohet buxhetit të Republikës së Kosovës për shkak të këtij mosveprimi është minimalisht mbi 35 milion euro.

## 7. Pasojat socio-ekonomike

Në kontekstin e sfidave socio-ekonomike aktuale, zbritja e përvojës së punës nga 0.5 në 0.25% sjell pasoja në jetën e familjeve të 90,696 zyrtarëve publik. Reduktimi i tillë i përvojës së punës, i cila rezulton në humbje prej, përgjithësisht në mesatare rreth 12.5 deri në 40 euro në muaj për secilin zyrtar publik, ka ndikim të drejtpërdrejtë në të ardhurat shtesë që këto familje mbështesin për të përballuar shpenzimet e përditshme.

Edhe pse shifra fillestare duket minimale, për familjet me të ardhura të kufizuara, humbja financiare si kjo ka efekt në mënyrën e jetesës. Çdo euro e humbur mund të ndikojë në aftësinë e familjeve të këtyre zyrtarëve për të investuar në arsimin e fëmijëve, shëndetësinë dhe nevojat bazë të jetës.

Raportet e ndryshme, përfshirë atë të UNDP-së, theksojnë se humbjet e vogla të të ardhurave, kur akumulohen me kalimin e kohës, mund të kenë efekte serioze sociale. Sipas këtyre analizave, gjatë që nga viti 2019 deri në vitin 2024, njëra ndër tre çështjet kryesore që qytetarët kosovarë i kanë preokupuar kanë qenë çmimet për furnizimet esenciale.[15]

---

[13] *Rregullore për Tarifat e Avokatëve*; Oda e Avokatëve të Kosovës; (Shih linkun: [https://www.oak-ks.org/assets/cms/uploads/files/Tarifat/Tarifa\\_e\\_Avokateve\\_e\\_dates\\_18\\_mars\\_2017\\_271533.pdf](https://www.oak-ks.org/assets/cms/uploads/files/Tarifat/Tarifa_e_Avokateve_e_dates_18_mars_2017_271533.pdf)), (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2025).

[14] *Udhëzimi administrativ nr. 012017 për unifikimin e taksave gjyqësore*; Këshilli Gjyqësor i Kosovës; (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/Udhezimi%20administrativ%20nr.%20012017%20per%20unifikimin%20e%20taksave%20gjyqesore%20shqip.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2025).

[15] *Përmbledhja e Pulsit Publik XXVI*; UNDP; (Shih linkun: <https://www.undp.org/kosovo/publications/public-pulse-brief-xxvi#>), (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2025).

Krejt kjo si pasojë e rritjes së normës vjetore të inflacionit e cila në vitin 2021 ishte 3.4%, në vitin 2022 ishte 11.6%, në janar të vitit 2023 ishte 11.9% dhe në dhjetor 2023 ishte 4,9% përderisa në vitin 2024 sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, inflacioni ishte 1.6%.[16] Në shumë raste, reduktimi i të ardhurave mund të çojë në ulje të konsumit për ushqim, për kujdesin shëndetësor dhe për arsim, duke rritur kështu rrezikun që familjet të bien në situata më të rënda të varfërisë dhe pabarazisë ekonomike.

Për zyrtarët publik, humbja e përvojës së punës nuk është vetëm çështje financiare, por gjithashtu prek motivimin dhe performancën profesionale. Kur të ardhurat shtesë zvogëlohen, ndjenja e vlerësimit dhe motivimit mund të ulet, gjë që më tutje mund të ndikojë negativisht në cilësinë e shërbimeve publike që ofrohen qytetarëve.

## 8. Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Siç u tha, zyrtarët publik janë dëmtuar dhe janë duke u dëmtuar për shkak të mosveprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Për shkak të dështimit të këtij institucioni që të veprojë sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese brenda afateve të përcaktuara nga kjo Gjykatë, zyrtarëve publik veçmë i'u ka lindur e drejta që të inicojnë procedurat gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre.

Neni 136 i Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka përcaktuar se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në komentarin e LMD-së, është theksuar me të drejtë se “[f]akti dëmtues mund të jetë aktiv ose pasiv... Pasiv është nëse personi përgjegjës nuk ka ndërmarrë një veprim të caktuar, të cilin me ligj ka qenë i detyruar ta ndërmarrë”. Po ashtu, komentari thekson se “për të ekzistuar përgjegjësia e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ai duhet të jetë shkaktuar me veprim, përkatësisht me mosveprim të kundërligjshëm. Në mënyrë të kundërligjshme vepron personi që me veprimin e vet apo mosveprimin e vet shkelë ndonjë normë të caktuar”[17].

Në përputhje me dispozitat e Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe praktikën e Gjykatës Supreme[18], për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte:

- a) që të shkaktohet dëmi;
- b) që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm;
- c) të ekzistojë faji i dëmtuesit;
- d) që të ekzistojë aftësia deliktore dhe
- e) të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Nga mosveprimi i Kuvendit si në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore që ekzistimit të detyrimit për kompensim dëmi.

---

[16] *Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit*; Agjencia e Statistikave të Kosovës; (Shih linkun: <https://askapi.rks-gov.net/Custom/972b64b8-75b2-4816-af65-340940a5ea88.pdf>), (Qasur për herë të fundit më 20 shkurt 2025).

[17] *Komentari i LMD-së*, Libri I, Ministria e Drejtësisë, 2013, faqe 158,160; Shih po ashtu praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme: Gjykata Supreme, Rev.nr.283/24, 22.07.20204, f.4; Gjykata Supreme, Rev.E.nr.37/2024, 22.10.2024 f.5. etj.

[18] Gjykata Supreme, Rev. nr. 283/24, 22.07.20204, f.4.

Duke pasur parasysh dëmet institucionale dhe buxhetore që krijohen në rast të mos përmbushjes së obligimit kushtetues të Kuvendit në lidhje me pagesën e përvojës së punës dhe duke pasur parasysh dëmi që u është shkaktuar dhe është duke i'u shkaktuar zyrtarëve publik, IKD kërkon nga Kuvendi që mos të detyrojë të njëjtit t'i drejtohen Gjykatës, por të përmbushë obligimin që ka. Megjithatë, IKD e ka parasysh se nëse Kuvendi nuk e bënë këtë, siç nuk e ka bërë brenda afatit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese, zyrtarët publik nuk kanë rrugë tjetër për realizimin e të drejtave të tyre pos se t'i drejtohen Gjykatës.

Në këtë drejtim, duke shpresuar në zbatimin e aktgjykimit nga ana e Kuvendit, me qëllim të lehtësimit të procedurës në Gjykatë, IKD tanimë ka draftuar një formë të padisë për kompensim dëmi në lidhje me pagesën e përvojës së punës. Kjo formë e padisë është arsyetuar në mënyrë shtjerruese dhe është ndërtuar në atë formë që të jetë lehtë e aplikueshme për secilin zyrtar publik. Kjo formë është pjesë e shtojcës 1 të kësaj analize.

## **Annex 1: Padia kundër Kuvendit**

IKD ka vlerësuar se në këtë situatë kemi të bëjmë me një rast strategjik, i cili përfshin një numër konsiderueshëm të lartë të qytetarëve të vendit dhe përmes vendosjes në këto raste, ndikohet në ndryshimin e praktikës institucionale apo politikave shtetërore, duke sjell ndryshime të qëndrueshme dhe pozitive në nivel shoqëror. Po ashtu, IKD ka konsideruar edhe parimet bazë të procedurës kontestimore dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë se gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesës së palëve, me qëllim që kërkesat e parashtruesve të jenë të parashtruara sa më saktë dhe vendimet e gjykatave të mundësojnë një mbrojtje të gjerë të të drejtave të qytetarëve. Andaj, në këtë drejtim, IKD ka vendosur që si pjesë e këtij raporti të përfshihet edhe një formë e padisë që mund të shfrytëzohet për inicimin e procedurës gjyqësore në këto raste, duke mundësuar kështu ushtrimin e plotë të të drejtave të sindikatave dhe çdo pale tjetër të interesit, me ç'rast të njëjtit mund ta përdorin këtë formë të padisë me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të zyrtarëve publik.

## 1.1 Udhëzime për plotësimin e padisë

### Hapi 1 – Vërtetimi i pozitës në Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik dhe përvojës së punës

Çdo zyrtar publik duhet fillimisht ta vërtetojë kategorizimin e tij në bazë të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe të përlllogarisë vitet e përvojës së punës, e cila mund të vërtetohet përmes raportit nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës ose përmes punëdhënësit përkatës.

Pas kësaj, zyrtari publik duhet ta vërtetojë se sa është paguar sa i përket përvojës së punës (0.25% për çdo vit deri në 15 vite të përvojës së punës) dhe sa është dashur të paguhet për këto vite (0.5%). Pas kësaj, kalkuloni dëmin që u është shkaktuar (diferencën e papaguar) për datat nga 1 shkurt 2024 e deri në ditën e parashtrimit të padisë.

### Hapi 2 – Plotësoni të dhënat në padi

Të dhënat personale, së bashku me të dhënat e punësimit dhe pagesës në lidhje me përvojën e punës, shënoni në pjesët përkatëse të padisë, në të cilat janë lënë hapësirat e nevojshme “\_\_\_”.

Ju lutem, shënojini të dhënat tuaja të sakta: emrin, mbiemrin, pozitën ku jeni i punësuar, përvojën tuaj dhe përlllogaritni dëmin që ju është shkaktuar nga data 1 shkurt 2024 deri në datën e parashtrimit të padisë.

### Hapi 3 – Nënshkrimi dhe dorëzimi i padisë

Pasi të plotësoni të dhënat, nënshkruani padinë në tre kopje dhe dorëzoheni në Gjykatën Themelore në Prishtinë.



## 1.2 Forma e padisë

### GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

**PADITËS:** \_\_\_\_\_.

**I PADITUR:** Kuvendi i Republikës së Kosovës, Sheshi Ibrahim Rugova, nr. 5, Prishtinë (10000)

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-212 për Marrëdhëniet e Detyrimeve paditësit paraqesin këtë:

## PADI

### Për kompensim dëmi

Paditësi është i punësuar në \_\_\_\_\_ në pozitën si në vijim:

### Emri dhe mbiemri - Pozita - përvoja e punës

Provë: Aktemërimi/Kontrata e punës

Aktualisht, paditësit, varësisht pozitave të tyre, pranojnë pagat në përputhje me Ligjin NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik. Në përputhje me këtë ligj, përkatësisht nenit 6.6 të tij, paga bazë e paditësve rritet në bazë të përvojës së punës, në masën: 1) zero pikë njëzetë e pesë për qind (0.25%) për çdo vit të plotë pune, deri në pesëmbëdhjetë vite (15) punë; dhe 2) zero pikë pesë për qind (0.5%) për çdo vit të plotë pune, mbi pesëmbëdhjetë vite (15) punë.

Përmes Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, paditësve u është ulur pagesa për përvojën e punës. Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, tanimë i shfuqizuar përmes nenit 45 të Ligjit NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kishte përcaktuar që për çdo vit të përvojës së punës të kaluar në shërbimin civil dhe jashtë tij, përveç përvojës së kaluar në punë praktike, nëpunësit civil sipas këtij ligji i takon e drejta për shtesë në pagën bazë prej zero pikë pesë për qind (0,5%). Ndërsa, neni 6, paragrafi 6 i Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik e ka ulur këtë përqindje në 0.25% në pesëmbëdhjetë vitet e parë të përvojës së punës.

Kjo dispozitë e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik është vlerësuar si kundër kushtetuese nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në aktgjykimin në rastin KO79/23 Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se reduktimi i pagave për zyrtarët publik gjatë pesëmbëdhjetë viteve të para të karrierës së tyre, nuk është në përputhje me synimin e ligjit për të krijuar një sistem të unifikuar të pagave në sektorin publik.

Gjykata ka theksuar se ky veprim nuk është mbështetur nga një "qëllim legjitim" dhe, si rrjedhojë, nuk ka asnjë nevojë të shqyrtohet fare proporcionaliteti, pasi mungesa e një qëllimi legjitim nënkupton një shkelje të të drejtës në pronësi. Sipas kësaj vendimi, Gjykata ka konkluduar se ky reduktim i pagesës së përvojës së punës nuk është në harmoni me paragrafët 1 dhe 2 të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me neni 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për mbrojtjen e pronës (Shih: Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim në rastin nr. KO79/23, parashtrues Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 23 janar 2024, par. 362-372).

Kështu, Gjykata Kushtetuese konstatoi se neni 6.6 i Ligjit NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Por, siç mund të shihet edhe në arsyetimin e cituar, Gjykatat Kushtetuese nuk e shfuqizoi dispozitën në fjalë por e obligoi Kuvendin që brenda gjashtë muajve (deri më 1 gusht 2024) ta ndryshojë këtë dispozitë, duke mbrojtur nivelin e pagesës lidhur me përvojën e punës. Gjykata Kushtetuese e bëri këtë për shkak se sikur kjo dispozitë të shfuqizohej, atëherë çështja e pagesës së përvojës së punës do të kalonte në një zbrastësi juridike, për faktin se Ligji NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik shfuqizoi Ligjin paraprak që njihte këtë të drejtë (Shih: Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim në rastin nr. KO79/23, parashtrues Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 23 janar 2024, par. 380-388).

Kështu, përmes këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese e obligoj këtu të paditurën, Kuvendin e Republikës së Kosovës, që në afat prej gjashtë (6) muajve nga hyrja në fuqi e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për plotësimin dhe ndryshimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në pajtim me Kushtetutën dhe aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese Nr. KO79/23. Sipas Gjykatës Kushtetuese, efekti i ndryshimit të Ligjit duhej të shtrihej nga data e nxjerrjes së aktgjykimit dhe jo nga data e miratimit: duke balancuar parimin e sigurisë juridike dhe të drejtat dhe liritë themelore, Gjykata do të lë në fuqi paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në periudhën prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të këtij Aktgjykimi, duke i përcaktuar detyrimin Kuvendit, që brenda kësaj periudhe të ndryshojë dhe/ose plotësojë paragrafin 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar në pajtim me konstatimet e këtij Aktgjykimi. Në ndryshimin dhe/ose plotësimin e paragrafit 6 të nenit 6 të Ligjit të kontestuar, Kuvendi duhet të ketë parasysh që efektet e ndryshimit/plotësimit të tij në kontekst të lartësisë së shtesës për përvojën e punës burojnë që nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi (Shih: Gjykata Kushtetuese, Aktgjykim në rastin nr. KO79/23, parashtrues Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, 23 janar 2024, par. 380-382).

Si përfundim, Gjykata Kushtetuese e obligoj të paditurën që brenda afatit prej gjashtë (6) muajve të kthejë dispozitën lidhur me pagesën e përvojës së punës në të paktën 0.5%, e cila pagesë do të realizohej nga data e hyrjen në fuqi të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese (1 shkurt 2024).

Deri më tani, e paditura asnjëherë nuk ka vepruar në përputhje me obligimin sipas aktgjykimit të cituar të Gjykatës Kushtetuese. Kjo u ka shkaktuar dëm paditësve, në atë mënyrë që nga data 1 shkurt 2024 dhe deri më sot, për 15 vitet e para të përvojës së punës është duke u paguar në lartësi prej 0.25% të pagës, përderisa do duhej që pagesa të ishte në nivelin prej, të paktën, 0.5% të pagës.

Neni 136 i Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka përcaktuar se “Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”. Në komentarin e LMD-së, është theksuar me të drejtë se “[f]akti dëmtues mund të jetë aktiv ose pasiv... Pasiv është nëse personi përgjegjës nuk ka ndërmarrë një veprim të caktuar, të cilin me ligj ka qenë i detyruar ta ndërmarrë”. Po ashtu, komentari thekson se “për të ekzistuar përgjegjësia e personit përgjegjës për dëmin e shkaktuar, ai duhet të jetë shkaktuar me veprim, përkatësisht me mosveprim të kundërligjshëm. Në mënyrë të kundërligjshme vepron personi që me veprimin e vet apo mosveprimin e vet shkelë ndonjë normë të caktuar” (Shih komentarin e LMD-së, Libri I, Ministria e Drejtësisë, 2013, faqe 158,160; Shih po ashtu praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme: Gjykata Supreme, Rev.nr.283/24, 22.07.20204, f.4; Gjykata Supreme, Rev.E.nr.37/2024, 22.10.2024 f.5. etj.).

Në përputhje me dispozitat e Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe praktikën e Gjykatës Supreme (Gjykata Supreme, Rev.nr.283/24, 22.07.20204, f.4), për të ekzistuar detyrimi për kompensimin e dëmit duhet të plotësohen këto parakushte:

1. që të shkaktohet dëmi;
2. që dëmi të jetë shkaktuar me veprimin/mosveprimin e kundërligjshëm;
3. të ekzistojë faji i dëmtuesit;
4. që të ekzistojë aftësia deliktore dhe
5. të ekzistoj lidhja kauzale ndërmjet veprimit/mosveprimit të kundërligjshëm dhe dëmit.

Në këtë rast janë plotësuar këto parakushte ligjore që krijojnë detyrimin e të paditurës për kompensim të dëmit palës paditëse.

Sa i përket kushtit të parë, shkaktimin të dëmit, neni 137 i Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka përcaktuar se “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur)...”. Në rastin konkret, sa i përket përvojës së punës, paditësit nga data 1 shkurt 2024 e deri më tani janë paguar me vetëm 0.25% të pagës dhe jo me 0.5% të pagës, me çka paditësve u është penguar rritja e fitimit të tyre.

Sa i përket kushtit të dytë, dëmi në këtë rast është shkaktuar si pasojë e mosveprimit të të paditurës. E paditura, në kuptim të nenit 116 të Kushtetutës, ka pasur për obligim që deri më datë 1 gusht 2024, të plotësojë dhe ndryshojë Ligjin NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, në atë mënyrë që pagesa për përvojën e punës të kthehet në 0.5% të pagës bazë. Madje, obligimi theksonte se shtrirja e kësaj pagese duhet të ishte nga data 1 shkurt 2024. Kështu, e paditura ka pasur obligim që të veprojë deri më datë 1 gusht 2024 dhe këtë asnjëherë nuk e ka bërë. Pra, në këtë rast, dëmi është shkaktuar për shkak të mosveprimit të të paditurës.

Sa i përket ekzistimit të fajit, neni 140 i Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve ka përcaktuar se “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”. Në rastin konkret, nuk ka asnjë bazë të vetme që mund të përjashtojë fajësinë për mosveprim.

Në kuptim të nenit 153 Ligjit NR. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton se “Personi juridik përgjigjet për dëmin të cilin organi i tij ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij” e paditura ka përgjegjësi të plotë deliktore.

Kushti i fundit është ekzistimi i lidhjes kauzale ndërmjet mosveprimit dhe dëmit. Në rastin konkret, paditësit paguhen në lartësinë prej 0.25% për faktin e vetëm se Ligji NR. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nuk është ndryshuar sipas obligimit që e paditura ka pasur, i cili obligim ka derivuar nga neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe aktgjykimi KO79/23 i Gjykatës Kushtetuese. Sikur kjo të ndodhte, paditësit do të paguheshin në lartë prej, të paktën, 0.5% të pagës bazë.

Për këtë arsye, në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për tu konstatuar se e paditura, duke mos vepruar në përputhje me obligimin kushtetues sipas aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese nr. KO79/23, i ka shkaktuar dëm paditësve.

Sa i përket lartësisë së dëmit, siç u elaborua, duke filluar nga data 1 shkurt 2024, paditësit është dashur të paguhen me nga 0.5% të pagës për 15 vitet e parë të përvojës së punës. Për shkak të mosveprimit të të paditurës, të njëjtit janë paguar me nga 0.25% të pagës. Kështu, përmes mosveprimit, e paditura i ka shkaktuar dëm paditësve në shumat si në vijim:

Paditësja , në bazë të koeficientit të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ka pagën prej \_\_\_\_ euro. Ajo ka përcavojë pune \_\_ vite. Nga data 1 shkurt 2024 e deri më 1 mars 2025, për 15 vitet e para të përvojës së punës është paguar nga \_\_\_\_ euro në muaj e në total gjatë kësaj periudhe kohore \_\_\_\_ euro. Ndërsa, është dashur që të paguhet nga \_\_\_\_ në muaj e \_\_\_\_ gjatë kësaj periudhe kohore. Kështu, e paditura i ka shkaktuar dëm paditësit në shumë prej \_\_\_\_ euro.

Andaj, duke u bazuar në gjithë këto që u thanë më lart, paditësit kërkojnë nga gjykata që pas shqyrtimit të padisë duke u bazuar në dispozitat kushtetuese, ligjore, prova dhe fakte, të nxjerrë këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësve.

**II. DETYROHET** e paditura që paditësve t'ia kompensojë diferencën e pa paguar në emër të përvojës së punës, për periudhën kohore 1 shkurt 2024 - e deri në zgjidhjen definitive të kontestit, në shumën prej \_\_\_\_ euro, me kamatë ligjore prej 8%, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**III. DETYROHET** e paditura që t'i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Prishtinë,

Përfaqësuesi i të paditurve

\_\_ . \_\_ . 2025



Raporti **“Mosveprimi i Kuvendit shkel të drejtat e 90,696 zyrtarëve publik dhe rrezikon buxhetin shtetëror”** është realizuar nga Instituti i Kosovës për Drejtësi me mbështetjen e National Endowment for Democracy dhe Rockefeller Brothers Fund.



Instituti i Kosovës për Drejtësi  
Kosovo Law Institute  
Kosovski Institut Pravde



NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



Rockefeller  
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World